

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE "MOLOSËT" SH.P.K.

Në Sarandë, sot më datë 01-06-2024,

Ne

Elton Xhavara, atësia Nine, amësia Vjollca, lindur më 26-03-1979 në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Shyqyri Berxolli; Nd. 18; H. 2; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës biometrike me nr. BE3269647, shtetas Shqiptar me nr. personal H90326069Q,

si dhe

Marsela Haruni, atësia Lutfi, amësia Violeta, lindur më 02-01-1988 në Gramsh dhe banuese në Gramsh, me adresë Hajdar Reshit Kollare 01200014; Nd. 9; H. 1; Ap. 1; Gramsh; Gramsh; 3301; Gramsh, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 031410207, shtetase Shqiptare me nr. personal I85102050F,

me vullnetin tonë të lirë, të plotë, të pavesuar (i),  
sinqertë e të dakortësuar në mënyrë unanime me njeri-tjetrin(ii),  
me bindje ke aftësitë dhe kapacitetet tona njerëzore(iii),  
duke njohur vetënjohjen si mënyra më e mirë për ushtrimin e iniciativës së lirë private(iv),  
me dëshirë për të konkuruar në treg të lirë(v),  
si dhe besim ke zoti(vi)

me cilësinë e ortakëve themelues, në mungesë të dijenisë lidhur me ekzistencën e ndonjëpengesë ligjore për të ushtruar aktivitet tregtar në territorin e RSH, kemi vendosur themelimin e shoqërisë

### "MOLOSËT" sh.p.k.

Me nënshkrimin e këtij akti themelimi të shoqërisë tregtare "MOLOSËT" sh.p.k., ne nënshkruesit, si dhe njëkohësisht themeluesitë saj, marrim përsipër të realizojmë e të respektojmë të drejtat dhe detyrimet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

#### Neni 1

Në pajtim me nenin 49/1 të Kushtetutës së RSH, si dhe përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, po themelojmë shoqërinë "MOLOSËT" sh.p.k .

#### Neni 2

Shoqëria selinë qendrore e ka në Bashkinë Sarandë, rruga Mitat Hoxha, zona kadastrale 8641, pasuria nr. 26/387-n5, Kati përdhe. Kohëzgjatja e shoqërisë parashikohet të jetë 10 vjet, por ky afat mund të ndërpritet apo zgjatet më tej, gjithmonë në funksion të kompetencave dhe diskrecionit të ortakëve themelues.

#### Neni 3

Aktiviteti shoqërisë mund të zhvillohet në të gjithë territorin e RSH, por ai mund të ushtrohet dhe jashtë këtij territori, me hapjen e filialeve apo nëpërmjet veprimtarive të tjera të karakterit përkatës duke respektuar rregullat për nxirrjen e NUIS sekondar, regjistrimi tyre në QKB, apo marrëveshje të tregëtisë së lirë.

#### Neni 4

Themeluesite shoqërisë "MOLOSËT" sh.p.k., me këtë akt-themelimi marrin përsipër që të respektojnë të gjitha detyrimet që parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, si dhe t'i përmbahet kriterëve të respektimit të politikave tregtare që zhvillohet sot e në të ardhmen në RSH.

#### Neni 5

5.1 Kapitali principal i shoqërisë "MOLOSËT" sh.p.k. në momentin fillestar të krijimit të saj është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili regjistrohet në llogarinë e shoqërisë pranë bankës Raiffeisen Bank. Kapitali është barazvlefshëm me 2 kuota.


Nr.	Emri i ortakëve	Kuota	Kapitali në vlerë monetare ALL	Përqindja në kapital
1	Elton Xhavana	1	50.000 (pesëdhjetëmijë)	50%
2	Marsela Haruni	1	50.000 (pesëdhjetëmijë)	50%
TOTALI		2	100.000 (Njëqind mijë)	100%

5.2 Me regjistrimin e shoqërisë pranë QKB, si dhe pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore në Sarandë, starton edhe fillimi i aktivitetit tregtar me kapital themeltar 100.000 lekë i kësaj shoqërie, i cili mund të zmadhohet ose zvogëlohet sipas rregullave të parashikuara në statutin e shoqërisë, si dhe legjislacionin në fuqi në momentin e ndryshimit të kapitalit.

5.3 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar miratohet nga asambleja e përgjithshme, me shumicë të kualifikuar (tre të katërtat). I njëjti rregull zbatohet edhe për pranimin e ortakëve të rinj, apo rishpërndarjen e kuotave. Po kështu edhe zvogëlimi kapitalit bëhet duke respektuar kërkesat e nenit 87 të ligjit nr.9901/2008, normave që parashikon shprehimisht statute shoqërisë, por jo nën minimumin ligjor.

5.4-Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe e vërtetuar para noterit. Kalimi kuotës tek bashkëpronarët ekzistues nga njoftimi deri tek kalimi çmimit blerjes është 90dite. Kalimi tek i treti bëhet pasi është ezauruar procedura e njoftimit 20 ditë dhe afati maksimal 90 ditë. Ortakët ekzistues njoftohen një për një. Si rregull parablerja bëhet duke respektuar kuotën përpjestimore kundrejt çmimit të orfuar nga i treti.

5.5- Ortakët ekzistues detyrimisht brenda afatit 20 ditor, nga e nesërmeja e marrjes së njoftimit, duhet të konfirmojnë zyrtarisht kundrejt ortakut që do të shes kuotën, lidhur me ofertën e të tretit për ta parablerë përpjesshmërisht, ose si e vlerësojnë ata veç e veç apo të gjithë bashkë me përqindje si e vlerësojnë ortakët ekzistues.



5.6- Nëse afati përcaktuar në pikën 5.5 të këtij neni ezaurohet pa përgjigje, shtuar shtatë ditë afatin njoftimit postar, parablcrja konsiderohet e ezauruar.

5.7-Kuota trashëgohet nga trashëgimtarët e ortakut, të cilët bashkë me të drejtën mbi trashëgimin , mbi ta rëndojnë edhe detyrimet sipas kuotës. Pas regjistrimit të kuotës, ortakët e rinjë, nëse duan ta transferojnë kuotën brenda rrethit të trashëgimtarëve të ortakut të vdekur, janë të lirë ta bëjnë pa respektuar parablcrjen.

5.8-Trashëgimtarët e kuaotave, apo përfituesit e kuotave nga falimenti, nuk kanë të drejtë të votojnë në asambleshë e përgjithshme pa u bërë regjistrimi kuotës në QKB.

### Neni 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "MOLOSËT" sh.p.k .do të jetë:

#### I.VEPRIMTARI NDËRTIMI

- Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj.
- Prodhimi i materialeve ndërtimi.
- Ndërtime civile dhe ekonomike, indistruale, turistike, bujqësore, mbi dy kate, si dhe kompletimin me instalimet e sistemeve të rrjeteve të nevojshme për to.
- Ndërtime rrugore,
- Ndërtim i veprave te artit, si dhe ristrukturime & restaurime veprash.
- Ndërtime hidroteknike. si ujësjellësa, puse, K.U.Z. ndertime , vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese, ndërtime impiante të trajtimit të ujit, ndërtime impiante të trajtimit të mbeturinave, punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik.
- Vepra të veçanta dhe punime speciale.
- Punime restaurimi.
- Punime karpentierie.
- Punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal dhe punime mirëmbajtje
- Punime topogjeodezike, gjeologjike, hidrogjeologjike.
- Punime hekurudhore, porte, aeroporte civile dhe ushtarake,

II. Zhvillimin e tregëtisë me pakicë e shumicë për shitjen e materialeve industriale, ushqimore dhe të ndërtimit, prodhimin e tyre, import eksportin e tyre, si dhe transport brenda dhe jashtë vendit .

III. Zhvillim dhe Administrim i institucioneve arsimore, jopublike, parauniversitare dhe i institucioneve arsimore plotësuese jopublike, institucioneve arsimore jopublike të arteve dhe atyre sportive.

IV.Zhvillim dhe administrim i institucioneve të shërbimeve spitalore.

V. Në fushën e sigurisë fizike dhe pronës.

VI. Zhvillim dhe administrim i klinikave ligjore apo konsulencës në fushën juridike.

VII. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj edhe në fushën e veprimtarisë finaciare të transferimit të parave në emër e për llogari të subjekteve financiar jo banka si "Agjent i transferimit të Parave që operojnë me të cilat do të realizojë marrëveshje.

VIII. Dhënie automjeteve dhe mjeteve detare me qira, ndërtimi dhe instalim oficinash mekanike dhe elektrike për konstruimin, ndërtimin, instalimin, si dhe riparimin e mjeteve motorike me djegje të brendshme, elektrike, apo fuqi ere.

IX-Ndërtim, arredim, si dhe administrim objektesh për organizim eventesh artistike, muzikale, disko, pabe, si dhe shtëpi diskografike,

X-Marrje me qira e plazheve publike dhe private. Ndërtim dhe administrim molesh për anije peshkimi, turizmi, apo jahte.

XI-Veprimtari të tjera

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë sipërmarrëse të shoqërisë do të hyjë edhe çdo veprimtari tjetër industriale tregtare, kulinare, artizanale, financiare, turistike, sportive dhe që konsiderohet nga ortakët themelues si të nevojshme dhe të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e objektivit të shoqërisë.

## NENI 7

Organet drejtuese, korumi, marrja e vendimeve, Organi ekzekutiv

7.1- Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm drejtues i shoqërisë "MOLOSËT" shpk, si dhe është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

7.2- Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

7.3- Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria Molosët" shpk nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur provon se i treti ka pasur

eni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për

7.4- Kur shoqëria Molosët mbetet me një ortak të vetëm, detyrohet ta regjistrojë këtë fakt sipas nenit 43 të ligjit 9723/2007, i ndryshuar.

7.5- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901/2007.

7.6- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

7.7- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 7.1 të këtij neni, lidhur me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

7.8- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7.1 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

7.9- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

7.10- Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria MOLOSËT ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

7.11- Votimi bëhet nga vetë ortakun, përfaqësuesi i autorizuar, por gjithëonë nese ka shlyer detyrimin për kuotën që zotëron.

### Neni 8

NeOrtakëthemelues, kemi vendosur që si administrator të jetë zoti Elton Xhavera, me të drejtë rizgjedhje,periodike, deri në një kohë të dytë, të cilën do ta caktojmë me vendim të arësyetuar, nëse rrethanat eventuale do na kondicionojnë një gjë të tillë.

-Administratori përgjigjet mbi bazën e kompetencave, si dhe diskrecionit të përcaktuar në këtë akt themelimi e statutin e shoqërisë. Në cilësinë e ortakëve themelues kemi vendosurlidhur me pranimin e ortakëve të rinjë, si dhe urdhërohetadministratori të regjistroj në QKB emrat e oratakëve që mund të shtohen, pjesët e kapitalit themeltar si dhe shumat e derdhura nga scicili. Në çdo shitje apo transferim kuotash, duhet të jemi nënshkruet të kontratës përkatëse duke dhënë pëlqimin vetë direkt, ose me prokurë të posaçme, ku disponohet detyrimisht enkas për objektin e transaksionit.

-Administratori është përgjegjës për administrimin e vlerave pasurore të shoqërisë, të çdo natyre qofshin, shlyerjen e detyrimeve fiskale, si dhe ato ndaj të tretëve. Mbi bazën e kontributeve të ortakëve, me vendim të arsyetuar të tyre, caktohetshpërndarja e fitimit, dividendi, si dhe rishpërndarja e kuotave.

-Organ ekzekutiv i shoqërisë "MOLOSËT" sh.p.k., është administrator. Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e tij, rregullohen me ligjin nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga ky akt themelimi të shoqërisë, statuti i shoqërisë, marrëveshjet eventuale që do të nënshkruhen gjatë aktivitetit, si dhe akte të tjera që mund të dalin nga asambleja e përgjithshme e ortakëve.


#### Neni 8

-Mandati i administratorit Elton Xhavara, për administrimin në kësaj shoqërie, është për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhje nëse do të gjykohet nga vetë ai, deri edhe pa limit. Administratori apo atij që i delegohet ky pushtet, ka të gjitha kompetencat të cilat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon, për të përmbushur, si dhe çdo detyrim të çdo lloji natyre dhe karakteri që lindin nga statuti i shoqërisë "MOLOSËT" Sh.P.K., si dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

#### Neni 9

Simboli, vula, si dhe motoja e shoqërisë janë:

a) Simboli është logoja e mëposhtme.



b) Motoja: Evoko të kaluarën e lavdishme të të parëve tanë, kontrakto stafin dhe punonjësit e duhur, kontrollo, verifiko, delego pushtet, zbato ligjin, si dhe ndiq e besoj instiktin me qëllim final: "Shërbimi ndaj të tjerëve, lumturia e tyre gjatë pushimeve, kënaqësia jonë". Sendet dhe frutat e sendeve të prodhura nga "MOLOSËT" Shpk, shtojnë dhe begatojnë cilësisht jetën, pa dëmtuar të tjerët dhe mjedisin".

Vula do të jetë me tre shirita me gërma kapitale shqip, ku nga sipër poshtë shprehimisht në rreshta do të shkruhet:

- i. Shiriti parë –MOLOSËT SH.P.K
- ii. Shiriti dytë –SARANDË
- iii. Shiriti tretë shënohet NIUS që do të merret nga QKB-ja pas regjistrimit. Teksti do të qëndërzohet në mënyrë simetrike.

#### Neni 10

-Ky akt themelimi hartohet në 5 ekzemplar original, duke patur secili prej tyre vlerë të njëjtë ligjore e kuptimore.

#### Neni 11

-NeOrtakëthemelues Elton Xhavera dhe Marsela Haruni, të vetëdijshëm dhe bashkë përgjegjës me nga 50% secili për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky Akt-themelimi i shoqërisë "MOLOSËT"Sh.p.k., pasi vlerësojmë dhe e gjejmë në pajtim me Kushtetutën e RSH, ligjin nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me vullnetin tonë të lirë, të plotë, të pavesuar, duke mos pasur asnjë rezervë dhe vërejtje për frymën,si dhe përmbajtjen tekstuale të tij, e miratojmë duke e nënshkruar rregullisht si më poshtë:

#### ORTAKËT THEMELUES

Elton Xhavera

Elton Xhavera



Marsela Haruni

Marsela Haruni

